

Vendim nr. 224 datë 08.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 08.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (I) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ISLAM KASA (MITRALOZI)

OBJEKTI: Interpretimi kushtetues nëse duhet t'u njihen përfitimet ligjore të dhëna me ligjin për amnistinë shtetasve shqiptarë që përmbushin kriteret përfituese, për të cilët, sipas legjislacionit penal shqiptar dhe me procedurë të rregullt gjyqësore, u është bërë njohja e vendimeve të formës së prerë, të marra nga shtetet e huaja.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 122/2011, datë 10.02.2011 të Gjykatës së Apelit të Bolonjës, Itali, kërkuesi Islam Kasa (Mitralozi), është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal italian dhe është dënuar me 8 vjet burgim. Për aktivitete të mëtejshme të paligjshme, me vendimin nr. 3975/2019 të po asaj

gjykate, kërkuesi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i lëndëve narkotike”, të parashikuar nga nenet 73 dhe 110 të Kodit Penal italian dhe është dënuar me 17 vjet, 10 muaj e 10 ditë burgim.

2. Në vijim, autoritetet e drejtësisë italiane kanë nxjerrë urdhrin e ekzekutimit nr. SIEP-523/2020 për bashkimin e dy dënimeve në ngarkim të kërkuesit dhe në bazë të nenit 110 të Kodit Penal italian, si dhe neneve 73 dhe 80 e vijues të dekretit nr. 309/1990 të Presidentit të Republikës të Italisë, i kanë caktuar përfundimisht dënimin me 23 vjet, 1 muaj e 7 ditë burgim për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, në formën e grupit kriminal.

3. Rezulton se kërkuesi është shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe pas arrestimit nga autoritetet shqiptare, me vendimin nr. (11-2021-3827) 570, datë 23.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është bërë njohja dhe konvertimi i vendimeve të formës së prerë të marra nga autoritetet e drejtësisë italiane. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2021-1666 (280), datë 04.10.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

4. Në vitin 2023 kërkuesi ka paraqitur kërkesë pranë gjykatës me objekt përfitim nga amnistia e vitit 2012. Më pas rezulton se ai ka hequr dorë, për pasojë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 48 (288), datë 29.01.2024, ka vendosur të deklarojë të papranueshme kërkesën për shkak të heqjes dorë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 03.05.2024.

5. Në datën 14.08.2024 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar nga Gjykata që të interpretojë nëse ai është në kushtet për të përfituar nga ligji nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie” (*ligji nr.107/2012*), si dhe që t’i japë atij informacionin për procedurën e parashikuar nga ky ligj. Sipas kërkuesit, ky pretendim ka lindur, pasi gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që ka shqyrtuar kërkesën për përfitim nga amnistia është shprehur se ai nuk mund të përfitonte dhe, në këto kushte, kërkuesi e ka tërhequr kërkesën e tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës

7. Gjykata ka vlerësuar juridiksionin e saj dhe legjitimitimin e subjekteve, si aspekte kryesore, që mundësojnë fillimin e procesit kushtetues, bazuar në nenet 131 dhe 134 të Kushtetutës, të lidhura me përmbajtjen e nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000. Kjo dispozitë e fundit parashikon, ndër të tjera, se kërkesa e paraqitur në Gjykatë nuk kalon për shqyrtim në seancë plenare kur kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk hyjnë në kompetencën e saj (*pika 2, shkronja "a"*).

8. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, që parashikon: “1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.”. Juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 i saj përcakton kompetencat kryesore të Gjykatës, ndërsa neni 134 përcakton subjektet që e vënë në lëvizje atë, të cilat nuk mund të lexohen të shkëputura nga dispozitat e tjera kushtetuese materiale ose procedurale që përkufizojnë kompetencën, si dhe përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën për vënien në lëvizje të kësaj Gjykate (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka kërkuar interpretimin e ligjit nr. 107/2012, si dhe ka kërkuar nga kjo Gjykatë që ta informojë lidhur me procedurat për të përfituar nga amnistia. Në këtë situatë, Kolegji çmon se duhet analizuar nëse interpretimi i ligjit bën pjesë në juridiksionin kushtetues, në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore që normojnë kompetencat e Gjykatës.

10. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj se, si rregull, interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur interpretimi i ligjit i nënshtrohet kontrollit kushtetues, ky kontroll ka natyrë *subsidiare*, pasi kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, në radhë të parë, funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 13, datë 09.03.2021; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Duke analizuar të dhënat e mësipërme në raport me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji vlerëson se kërkimi i paraqitur nga kërkuesi ka të bëjë me interpretimin e ligjit për amnistinë dhe me procedurat e përfitimit nga kjo amnisti, e cila nuk hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate, për rrjedhojë kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.